



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.317/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj - kryesues, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Shkelzen Xhaferi, kandidat për anëtar të kuvendit komunal të Komunës së Vushtrrisë, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të paraqitur kundër Qendrës Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave me kusht për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 24.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa ZL.Anr.317/2025, datë 23.10.2025, e parashtruar nga Shkelzen Xhaferi, kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Vushtrrisë, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të paraqitur kundër Qendrës Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave me kusht për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 23.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e parashtruar nga Shkelzen Xhaferi, kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Vushtrrisë, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të paraqitur kundër Qendrës Numërimit dhe Rezultateve (QNR), me të cilën pretendon se në vendvotimin 2701/VK, janë keqnumëruar fletëvotimet e arritura me kusht dhe se me janë deklaruar më shumë vota me kusht, andaj kërkoj që të rinumërohet ky vendvotim.

Në përgjigje në ankesë të KQZ-së, datë 24.10.2025, sqaron se, pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese, të kandidatit për kuvendin komunal në Vushtri, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, Shkelzen Xhaferi theksohet se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN.

Procesi i numërimit të votave me kusht kryhet në përputhje me nenin 20 dhe 22 të Rregullores Zgjedhore NR.14/2024, Qendrat e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) të cilat rezultate nëse ka mospërputhje mund të korigjohen dhe korrektohen.

Me tutje, KQZ thekson se sa i përket pretendimeve të palëve ankuese që mbështeten në pritshmërinë dhe deklaratimet e personave, dhe familjarëve të tij, duke theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit, votuesi në fletëvotim që është në kundërshtim me parimin kushtetues të fshehtësisë së votës, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të merret si fakt provues.

KQZ, ju njofton se, rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimueshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre.

Po ashtu, në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se palët ankuese, nuk ka bashkëngjitur prova të mjaftueshme që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e tij të paraqitura në ankesë. KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe votat me kusht, gjenden në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës konstaton se:

- Ankesa është e pa bazuar.

Paneli pas shqyrtimit të ankesës, përgjigjes në ankesë të KQZ-së, vlerësoj se pretendimet në ankesën e parashtruar nga Shkelzen Xhaferi, kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Vushtrrisë, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të paraqitur kundër Qendrës Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave me kusht për Zgjedhjet Lokale, është i pabazuar për faktin se e njëjti nuk ka arritur që të vërtetoj, përkatësisht të dëshmoj faktin se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pala ankuese pretendon me ankesën e tij, kjo pasi që paraqitësi i ankesës nuk i ka bashkëngjitur ankesës asnjë provë të vetme që të argumentoj pretendimet e tij se ka ndodhur një veprim i tillë në QNR. Kurse pretendimet e theksuara më shumë janë supozime se sa thënie të dokumentuara në fakte dhe në prova konkrete.

Andaj, Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga Shkelzen Xhaferi, kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Vushtrrisë, është e pabazuar pasi që nuk ka bashkëngjitur asnjë provë lidhur me parregullsitë e pretenduara se ka pasur keqnumërim të votave me kusht, nga fletëvotimet e numëruara në QNR, mbetet vetëm i natyrës deklarative dhe se nuk është mbështetur me asnjë provë që do të dëshmonte pretendimet ankimore. Andaj duke u mbështetur

në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe nenin 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.317/2025, datë 24.10.2025



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.